

PATOOGJENEZA E AFONISË FUNKSIONALE (HISTERIKE)

Kand. Shken. Mjek. HQOMET DIBRA
Spitan i përgjithshëm ushtarak.

Në artikujt e mëparshëm është trajuar etiologja dhe klinika e afonisë funksionale, ndërsa ketu do të merremi me studimin e nevrozës histerike në përgjithësi dhe të afonisë funksionale në vëgantë si një çregullim i proceseve të veprimitave së çregullimeve funksionale në vëgantë si një se duket i thjeshtë në vështrimin e parë, në të vërtetë është shumë i ndërlikuar. Mendimet e ndryshme dhe divergjencat që kanë autorët mbi këtë problem vijnë nga se këto «çregullime të zërit» nuk kanë një «substratum anatomic», por janë të natyres funksionale, sikundër e tregon edhe epiteti që i cilëson. Më poshtë po rreshtojmë disa nga pikë-çfaqur dhe vërejtjet tona në këtë drejtim.

V. Voorhis (1954) e konsideron afoninë funksionale si një nga simptomat e «histerise». Kjo është e drejtë vetëm në ato raste kur «marriat»-abazi, kontrakturë etj., d.m.th. kur ajo është një simptomë «gnue» e gjendjes histerike. Ndërsa në rastet tona afonia mbizotëron tiё gjithë tablonë, ajo është i vetmi simptom kryesor që përfaqeson këtë «gjendje morbide» të vegantë.

N. Winkelmann (1937), duke e konsideruar afoninë funksionale si një «prirje kah sémundja», largohet nga e vërteta. Po ta quajmë historianë një sémundje, sikundër shprehet I.P. Pavllovi, pikëpamja e tij nuk është e drejtë.

James Green (1934) dhe K.M. Gaskei (1946) përpigen ta shpjegojnë thelbën patogjenik të afonisë funksionale me anë të faktoreve emocionale, duke lënë pas dore shkakun e vërtetë patogjenik të lindjes dhe zhvillimit të këtij manifestimi nevrotik. Roli i emocionit, sic thonë Babincki dhe I.P. Pavllovi, është shumë i rëndësishëm në lindjen dhe zhvillimin e manifestimeve histerike, por i pamjaftueshëm në vërvete për të shpjeguar patogjenezën e histerie.

Charcot (1884), Gilles de la Tourette (1892) dhe Grassét (1900) mendojnë se në bazë të aksidenteve histerike, sikundër janë belbëzimi, lembza dhe afonia, qëndrojne «spazmat nervore». Kjo pikëpamje, ndoshpjegon thelbën patogjenik të afonisë, mbasi vëtë spazmet janë simptoma.

F.D. March dhe F. Douglas (1932) përfshijnë në patogjenen e afonisë funksionale, përvetë laringtit, edhe inflamacionet e rrugëve të sipërme t'aparatit të frysëmarrjes, si dhe alteracionet inflamatore të

amigdaleve, të dhëmbëve dhe të hundës. Plikëpamja mbi rolin e faktorit «inflamator» është një shpjegim mekanik i pjesëshëm mbasi nuk mbështetet në baza fiziologjike. Prapa faktorit etiologjik organik fshihet «faktori psikogenik», që shartohet në një terren me procese të dobët nervore ose në një tip të astenizuar.

Një shpjegim mjaft interesant të mekanizmit të patogjenezës së gregullimeve funksionale të zërit u mundua ta japë E.D. Friedmann. Simbas tij «gregullimet fonatore duhet të shikohen si dëmtimi të gyrus praecentralis, aty ku gjendet qendra motore e aduktoreve». Kjo pikëpamje nuk është e drejtë. Është e vërtetë se qendra motore e fonacionit ndodhet në afersitë e gyrus praecentralis dhe dëmtimi i saj sjell gregullime të fonacionit dhe të fjalës, kur ka lezione organike. Kurse në rastet tona kemi të bëjmë me gregullime të natyrës funksionale të qendrës së aduktoreve në gyrus praecentralis. Me fjalë të tjera, këtu kemi një lloji katalepsie «histerike» të kufizuar vetëm në aparatin e fonacionit. Në dritën e teorisë së I.P. Pavlovit ky është një inhibicion i qendrës motore t'aduktoreve.

Engjashme me këtë pikëpamje është edhe ajo e Chevalier Jackson (1949), i cili bën një analogji në mes të afonisë funksionale dhe paralizës tranzitore të aduktoreve që lind si pasojë e një të metë të qarkullimit të gjakut (zakonishët anemë cerebrale) në pjesët e përparme të korteksit cerebral. Simbas tij «sensacioni fizik që ka i sëmuri se nuk është në gjendje të flasë, fiksohet dhe këshfu stabilizohet afonia psikosomatike». Ky shpjegim i patogjenezës së afonisë funksionale është i njëanshëm dhe hipotetik. Jackson përpinqet ta sqarojë afoninë nga ana «psikosomatike», duke lënë mënjanë fiziologjinë.

R.Z. Amirov dhe V.P. Hrakovskaia-Cernjak (1947) mendojnë se si bazë etiopatogjenike e gregullimit funksional të zërit është «reflexi i kondicionuar patologjik». Ndërsa simbas N.V. Bjelloggolov «kur nuk ka lexione patologjike të dukëshme në larings, gregullimet e zërit duhet të konsiderohen të natyrës nevrotike, histeri ose nevrasteni». Këto pikëpamje janë të drejta dhe mbështeten në doktrinën e I.P. Pavlovit, ndonse nuk e trajtojnë plotësisht problemin e patogjenezës së gregullimeve funksionale të zërit.

Ndër autorët me autoritet të kohës së sotme, duhet të përmendim N.J. Krasnogorski, S.N. Davidenkov, P.D. Gorizontov, A.I. Gordijenko; simbas tyre në bazë të mekanizmit të afonisë funksionale qëndron «aftësia që ka sistemi nervor të fiksojë formimin jo të drejtë të zërit në sajë të reflekseve të kondicionuara patologjike».

Ne mendojmë se çështja e patogjenezës së gregullimeve funksionale të zërit duhet të shqyrtohet në kuadrin e nevrozave në përgjithësi dhe të histerisë në veganti, duke u mbështetur në doktrinën e I.P. Pavlovit. Simbas I.P. Pavlovit dhe nxënësve të tij (K.M. Bikov, L.A. Orbeli, A.G. Ivanov-Smolenski, N.I. Krasnogorski etj.) gregullimet funksionale në përgjithësi mbështeten në mekanizmin e fiksimit të zakonit patologjik, që zhvillohet në bazë të reflekseve të kondicionuara. Si rrjedhim, në etiopatogjenën e gregullimeve funksionale të zërit ka rëndësi koïncidencia e dy faktorëve: gjendja nevrozike dhe momenti determinues i afonisë. Kurse përsë i përket meka-

nizmit, të patogjenezës së këtyre çregullimeve, rëndësi të madhe ka për ne formimi i reflekseve patologjike të kondicionara.

Nga mësimet e I.P. Pavlovit mbi bazat patofiziologjike të neurozave del se afonia funksionale, si një nga manifestimet e histerisë, është një gjendje e sëmure.

Sikundër u theksua më lart, afonia funksionale duhet të bëhet në kuadrin e përgjithshëm të nevrozave. Interpretimi i drejtë i kësaj «gjendje morbide funksionale» duhet të bëhet vetëm në rezulton nuk është gjë vrozës histerike, mbasi afonia funksionale sigurisht është gjë tjetër: veçse një çfaqje monosimptomatike dhe një formë e nevrozës histerike.

Ne literaturën mjekësore bëhet fjalë për lloje të gjendeve të afrove të histerisë (konvulsione, distorsione, paraliza, çregullime të të dëgjuarit, kontraktura, anestezira, histeri komanduese). Nganjëherë histeria ka qfaqje monosimptomatike (mutizëm, sordomutizëm, amaurosis, afoni, lenzë etj). Prandaj mund të themi se çfaqjet histerike të kohës së luftës kanë tipare dalluese nga ato të kohës së paqës.

Po të krahasojnë çregullimet histerike të konstatuara gjatë dy luftave botërore vërejmë një ndryshim të dukshëm. Ndërsa gjatë luftës së parë botërore mbizotërojnë format e histerisë komanduese, kamp-tokormite, konvulsionet e mëdha etj, në luftën e dytë u vuri re kryesht forma më të lehta, monosimptomatike, sidhe aksidente histerike të shartuara mbi një lezon organik (plagë, komociion, kontuzion etj). V.A. Giljarovski dhe S.N. Davidenkov, të cilët kanë studjuar manifestimet e histerisë gjatë luftës së Madhe Patriotike, konstatuan se rastet e sordomutizmit, të mutizimit dhe të afonisë ishin më të pakta se gjatë luftës së parë botërore. Autorët e mësparmë mendojnë se mutizimi dhe afonia janë kryesisht «manifestime histerike të kohës së paqës».

Simbas autorëve francezë dhe gjermanë, manifestimet histerike më të shpeshta në kohë paqe çfaqen kryesisht në turbullime funksionale të sferës motorike (paralizë, hemiplegji, kontrakturë, monoplegji, dridhje koreiforme etj). Çregullimet e sferës sensitive vijnë në radhë të dyte (algji, anestezi), pastaj vijnë turbullimet sensoriale të të dëgjuarit, të të pamit dhe më më fund të fjaletës e të zërit.

Këto të dhëna interesante përpunohen plotësisht me konkluzionet tona. Edhe çregullimet histerike të vërtetuarë më rastet tonë kanë një karakter të «zbetës». Kësia e dëshmon edhe forma e çfaqjes së tyre më trajtën e afonisë dhe jo më më format e rënda, trashamane të dikurëshme.

Faktorët e përgjithshëm pozitive që ndihmojnë më pakësimin e të gjitha çfaqjeve nevrolikë (permësëm i gjendjes ekonomike, ngjëtja e nivelit kultural dhe arësimor, kaltja progressive dhe e vazhdueshme fiziko-morale e punonjesve dhe vesanërisht e ushtarakëve etj), kanë ndikuar më uljen e ndijeshme absolute të manifestimeve histerike.

Të dhënat statistikore të Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak dëshmojnë për një pakësim të çfaqjeve të ndryshme histerike (duke përfshirë edhe afoninë funksionale) nga viti 1950 deri në vitin 1958. Në qoftë se marim si 100% numrin e rasteve të çfaqjeve të ndryshme të nevrozës histerike për vitin 1950, mund të përpilojmë pasqyrën e më poshtme për vitet e tjera.

1950	1952	1956	1957	1958
100%	84%	73%	67%	57%

Nga këto të dhëna del se në vitin 1958 rastet e çfaqjeve histerike janë thua jse gjysmuar. Interesant është fakti se rastet e afonisë, që janë çfaqje histerike më të lehta, janë shtuar gradualisht si përgjindje reë krahasim me numrin e përgjithshëm të manifestimeve histerike, duke arritur pikën kulminante në vitin 1956.

Tani le të shyrtojmë një anë tjetër të problemit: si duhet interpretuar çfaqja e afonisë funksionale nga pikëpamja e veprimit?

Afonia funksionale nuk mund të quhet kurresesi një «organone-vrozë» ose një «nevrozë lokale», siç mendojnë disa autorë. Ajo është manifestimi i një nevrose të përgjithshme, një çfaqje histerike që përfaqëson një «epifenomen funksional». Afonia funksionale dëshmon për prishjen e ekilibrit të veprimitarisë më të lartë nervore, ku gregullimet e zërit spikatin në tablonë e përgjithshme klinike, duke përfaqësuar simptomin primordial të nevrozës histerike. Në mjaft raste simptomat e tjera funksionale mungojnë ose hyjnë në plan të dytë.

Në favor të temës mbi çfaqjen e afonisë si rezultat i gregullimit të veprimitarisë më të lartë nervore flet edhe fakti se në pjesën më të madhe pacientët tonë janë tipa të dobët të veprimitarisë më të lartë nervore dhe më rrallë tipa të lodhur të astenizuar, konditë kjo kryesore për çfaqjen eventuale të aksidenteve newrotike. Këta njerëz gjunjëzohën më lehtë dhe më shpejt përparrë situatare të vësh-tira që konfliktuozë, përparrë tronditjeve shpirtërore.

Për të konkretizuar sa thamë, po japid një shembull nga praktika jone.

S.T. vjet 30, lindur në Korçë, dërgohet për **laringitis chronică** tek otojatri, i cili me 21-VIII-1957 e drejton në spital për konsultim. Ankohet se qysh prej marsit 1957 i është marre zëri dhe nuk mund t'u flasë normalisht. Nevrikutet shpejt, qan, nuk ka gjumë dhe mërr zibet shumë.

S.T. Lindi dbe u rrit në qytet në kondita të mesme. Ka kryer 4 klasë fillore. Eshtë marrë me punë shtëpie deri në moskën 19 vjec kur u martua. Lindi normalisht 3 fëmijë. Në fillim shkonte mirë me burrin, pastaj filluan grindje e mosmarrëveshje të thella, të cilat përfunduan me çkurorzim. Thotë se ka kaluar sëmundjet e fëmijërisë. Ka pasë angina të shpeshta, është operuar për flegmon të amygdalës më 1948.

Ka afro 2 vjet që është ndarë nga bashkëshorti. Tani rron tek një vëlla i saj, dhe punon në fabrikë.

Në fëmijëri ka denë e dobët, e frikëshme (natën trembej shumë) dhe e pavendosur. Eshtë shumë meraklik, mërzitet shpejt, grindet kolaj, sytë i mbushen me lötë për gjera të vogla. Shpesht nga zemrimi e zen lenza dhe kjo gjendie vazhdon 19 vje.

E ndjen vëtentë të sëmurrë prej dy vjetësh. Në fillim pati dhimbje banku mbasi ngriti peshë të rendë; këto dhimbje ndikuan nefativisht në mestruacionet. Konsultoi mjekë të ndryshëm, të cilët i këshilluan kura të ndryshme për mëqinë e zezë, stomakun, veshkat

etj. Është shtuar 4 herë në Spitalin Civil të Korçës. Nuk punonte dot, sepse lëdhej pa masë. Në muajin prill 1957 iu pre menjëherë zëri. Kjo i ndodhi pikërisht ditën që gjyqi dha vendimin e çkurozëmit, dhe i la bashkeshorrit të saj dy fëmijet. Menjëherë iu bë një lëmsh në grykë që e pengonte të flasë e të marrë frymë, kështu iu pre zëri fare për 5 ditë; pastaj i erdhë pak si rezultat i mjekimeve lokale (penicilinë, gargarizma, inhalacione etj.). Megjithatë konsultoi mjekë të ndryshëm, zëri nuk i erdhë normalisht. Duke parë se kjo gjende po vazhdonte për një kohë të gjatë, u nis për konsultim në Tirane. Otojaturi i këshilloi një ekzaminim neuropsihik.

Status praesens: ulët. E quan vehten të paftat; askush nuk ia qan zëm etj.

Gjendja e përgjithshme jo e keqe. Lëkura dhe mukozat koloruara normalisht. Zëmra tone të qarta, herë pas here ndihet ndonjë ekstrastol ekspiratore. Polmone asgjë. T.A. 140-80. Pulsi 88 në 1'. Abdomeni i butë, i trajtueshëm, në palpacion arkon dhimbje në hipogastër. Gjuha e pastër dhe e njomur.

Puplat midriatike, reakzionet fotomotore normale. Efkzaminimi neuro-Refleksi korneal dhe faringial të zhdukur. Dermografik: logjik: fizëm i kuq i theksuar. Në pikëpamje psikike: e sugjestionueshme, eksitohet kollaj, emocionohet shumë shpejt dhe qan lehtë kur flet përfëmijët.

Ekzaminimet para-30. Sed. 5. Urina normal. Cholesterinemia normale. Metabolizmi bazal +7. Elektrokardiograma normal. Skopia pulmonare normale. Skopia e tubit digestiv: gastritis. Wasermann në gjak negativ, Azotemia 0,28% Fe-çes — për vezë parazitash negativ.

Mjekimi: me procedurën e dominantit të dhimbjes menjëherë i erdhë zëri. Mbës këtij mjekimi e ndjen vehten minë.

Analizimi i rastit. vore, sikundër është S.T., traumat e ndryshme psihike (ndarja nga burri dhe fëmijët etj.) krijuan një gjendje të rrëndë dhe të padurueshme për sistemin e saj nervor të dobët. Tronditja e veprimitarës më të lartë nervore u qfaq në fillim me mutizëm, i cili më vonë u shndrrua në afoni. Fillimi, dekursi dhe shërimi i menjëherëm flasin qartë për natyrën nevrotike të kësaj marje zëri.

Njeriu në qdo kohë, në qdo vend, mund të ndodhet para situatash të vështira përfu kapërxyer. Tek njeriu normal fenomenet emocionale të shkaktuara nga një traumë psikike, goftë edhe intensive, frenohet nga vullneti, nga zotësia e të përmbyturit të vetevehtes. Këto fenomene zbehën dhe zhduken, kur shkaku provokes i pushon së ve-

pruari. Pra elementi emotiv në vetvehte nuk është i mjaffuteshëm përtë shikaktuar aksidente nervotike. E kundërtat ndodh me afonikët tonë histerike.

Të thelluarit në anamnezë tregon se në të kaluarën shumë nga pacientët tonë kanë dhënë shenja që provojnë se ata janë tipa të dobjë të veprimtarisë më të lartë nervore (sprirje për neurasteni, gjendje reaktive, çrrregullime psikastenike).

Nga observacionet tona klinike del se 25,90% të rasteve kanë qenë recidive. Shpesh herë nga anamnezi rezulton se në të kaluarën ose në një periudhë imediata përparrë çrrregullimit të zërit është vërtetuar një farë «ngjije e zërit», e shkaktuar nga proceset inflamatore të grykas, trakesë ose laringosit (angina, trachitis, laringitis). Duke u mbështetur në mësimet e I.P. Pavlovit, ne mendojmë se në rastet e përsëritura në konteksin cerebral krijohen pikat të sëmura me karakter transitor dhe funksional. Vatra e dikurëshme zgjohet nën veprimin e faktorëve or- ganikë dhe psikogenë, njëloj sikurse ndodh gjatë përsëritjes së kri- zave konvulsive ose të manifestimeve të tjera histerike. Kështu pra, formohet një «vatër» patologjike, funksionale në konteksin cerebral.

Prej kohësh dihet se histeria është prototipë e qafjet e zhvillohet në trajta të ndryshme sipas kushteve dhe kohës. Gjithashtu dihet se në të kaluarën ka pasë shpesh herë çfaqje massive të rjekohëshme manifestimesh histerike të një forme të caktuar. Në Lindjen e katytre fenomeneve massive ndikon «induksimi patologjik». Pa qenë nevoja të marrim shembuj nga Mesjeta e Lartë me «vallet» dhe «koret histerike», që merrnin përpjestime të mëdha, mjafton të përmendim përhapjen e «histerisë së madhe» në kohën e Charcot, si dhe manifestimet histerike kolektive që ka vërejtur Didier në disa institucione përvaja (1952).

Në studimin tonë, jemi kufizuar vetëm me rastet kur afonia është manifestimi i një gjendje histerike, duke lënë mënyranë të gjitha rastet këtë dyshohej për simulacion ose agravacion.

Në reënsionin e vlefshëm mbi disertacionin tonë që ka bërë Prof. K. Parhon — Stefanescu, shef i klinikës psiqatrike të Institutit të Mjekësise dhe Farmacisë të Bukureshtit, shprehet mendimi se sasia e konsiderueshme e rasteve të afonisë gjatë viteve 1954-1958, mund të spjegohet me të ashtuquajturin «imitimi patologjik» të çrrregullimeve psihike dhe nervore.

Edhe ne mendojmë se në rastet tona «imitimi patologjik» duhet të ketë luajtur një farë roli. Në këtë konkluzion na shtym mendimi se prania e ndonjë rasti sporadic në gjyrin e një kolektiviteti mund të shërbejë për të «induktuar» personat e tipit të dobet të veprimtarisë më të lartë nervore, tek të cilët në ato kohë rrund të koïncidojnë një tronditje shpirtërore në terren somatik shpesh herë të dobësuar nga lodhja, gripi, angina etj.

Duke marrë parasysh anamnezën, studimin e veprimtarisë më të lartë nervore të afonikëve tonë, sidhe faktorët etiologjikë dhe faktorët determinues të tronditjes së veprimtarisë më të lartë nervore rezulton se afonia funksionale është një varietet i neurozës histerike, që çfaqet në forme të lehtë e të stërholluar, sidomos në kohë paqe.

B i b l i o g r a f i

- 1) ARMIROV R. Z. Uslovenie refleksi o mehanizme LOR — zabolovanji. Trudi nos, uha, gorila. 1956.
- 2) BABINSKI J. M. — Définition de l'hystérie. Paris 1901. Hysterie, pithiatisme en neurologie de guerre, Masson, Paris 1917.
- 3) BIKOV K.M. — Kora golovnaya mozga i vnutrennie organi, Moskva-Leningrad 1957.
- 4) DAVIDENKOV S. M. — Opit Sovjetskoj Medicini v Velikoj Otečestvennoi Vojni. v. 20-26. 1941-1945.
- 5) DIBRA H. — 1) Faktorët etiologjikë që ndihmojnë në lindjen dhe zhvillimin e afoniave funksionale (histerike).
— 2) Dista të dhëna mbi klinikën e afoniave funksionale. Buletin i Shkencave Mjekësore Nr. 4/1961. dne Nr.1/1962.
Revue d'otoneuro-optalmo 1952 f. 24, 7, 425, 428.
- 6) DIDIER M.G. — Aphonie psychique en série dans une collectivité de femmes.
- 7) FRINDMANN E. D. — Neurological aspect of hoarseness. New-York State Jurnal, 1934, 34, 2, 48-50.
- 8) GASKEY K.M. — Aphonia. Annals of otolog. Rhinol. a. laryng 1946, 55, 3, 524, 530.
- 9) GILJAROVSKIJ V. A. — Psihiatrija, Medgiz, 1954. Konceptsiya refleksa na razlicnik etapah razvitiya psihijatri.
- 10) FILLES DE LA TOURETTE. — Traité clinique et thérapeutique de la l'hystérie d'après l'enseignement de la Salpêtrière, Paris 1884.
- 11) GRASSE. — Les psychoneuroses de guerre, Presse Médicale, Avril 1915. Paris.
- 12) GREEN JAMES. — Psychiatrische Behandlung der dysphonie. Aphonie, psychophonasthenie, fistelstomatitische. Arch. if. otob. 1938, 28, 213-221 Ref. Ebl. f. Hels — Nasen — u obrenheilk, 1939, 31, 9, 421.
- 13) JACKSON CHEVALIER — Psychosomatic aphony and ephemeral abductor paralysis Laringoscope, 1949, 59, 12, 1287-1298.
- 14) IVANOV — SMOLENSKIJ A. G. — Ocherki patofiziologii vishei nervnoj dejatelnosti po dannim I.P. Pavlova i jeho shkoli. Moskva, 1952.
- 15) HRAKOVSKAJA — CERNIAK V. P. — Diagnostika, i lecenie funksionalnih rostroistv golosa metodomi zaglushenia, Zh. Ush. Nos i goril. bol. 1937, 14, 5, 717-722.
- 16) KRASNOGORSKI NJ. Trudi po izuchenju vishoi nervnoj dejatelnosti čeloveka i zhivotnih V. 1, 1954.
- 17) MARSH F.D. — Functional aphony. Lancet 1932, II, 288.
- 18) ORBELI L. A. — Voprosi vishe nervoj dejatelnosti, Leksi i dakljad, 1928-1944 gg. Med. izd. Akademija nauk SSR, Seria «Itogi i problemi sovremenii nauk».
- 19) WOORHIS J. W. — Non surgical treatment of aphony. N/Y. State Y. Med. 1934, 34, 2, 53-55.
- 20) WINKELMAN H. W. — Diagnosis and treatment of hysterical aphony and diagnosis of molting in this cases. Med., clinice of North. Amer. 1937. 21, 4, 1211-1220.—

PATHOGENESIS OF THE FUNCTIONAL (HYSTERIC) APHONY

(Summary)

In this article the author discusses the problem of the pathogenesis of the functional disturbances of the voice that appear in the form of hysterical aphony. After reviewing critically the opinions of the most renowned of authors on this problem, the author treats these cases as a variety of hysterical neurosis and considers the pathogenesis of these voice troubles as analogous with that of hysteria in general. The author bases his conclusions mostly on the I.P. Pavlov's doctrine on the pathophysiological nature of the neuroses and considers the functional aphonies as a special form of hysteria, characteristic mainly for peace time. From the statistics

data we can see that in this country the different manifestations of hysteria have been diminishing gradually from 1950 to 1958, while the cases of functional aphonia have attained their maximum in 1956 and have thus replaced the other forms of hysteria.

The author thinks that functional aphonia should by no means be called a «local» neurosis, because it represents a functional epiphemonon determined by disturbances of the high nervous activity.

The author's observations show that most of these patients are of the weak type of high nervous activity. These subjects retreat more quickly and easily before any sort of hardship and conflicting situation, before any kind of psychic trauma.

Taking for basis the research work of the Pavlov school, the author concludes that for the etiology of the functional voice disturbances two are the factors that have the greatest importance: the neurotic state of the patient and the «releasing» moment of the aphonia. As for the mechanism of the pathogenesis of these disturbances, much importance has the creation of pathologic conditioned reflexes.

STANDARDET, PASQVRAT PËR VLERËSIMIN INDIVIDUAL DHE SKEMA E KARAKTERISTIKËS SË ZHVILLIMIT FIZIK TË SHKOLLAREVE TË QYTETIT TË TIRANËS

O. PAPADHIMITRI
Katedra e Sëmundjeve Intektive

Përpunimi i standardeve si dhe studimi sistematik i gjithanëshëm i gjendjes dhe dinamikës së zhvillimit fizik të fëmijëve dhe, posaçërisht, të nxënësve të shkollave, paraqitet vëcanërisht aktual. Një kërkesë e tillë e momentit gjen justifikim në faktin se, vendimet e K.Q. të P.P.SH. të vjetit 1958 mbi përmirësimin e punës në shkollat fona (11), para shikojnë edhe krijimin e kushteve të përshtatëshme të edukimit, në mënyrë që të forcohet, të kalitet shëndeti i nxënësve. Nga ana tjetër, organet e shëndetësisë janë vegenërisht të interesuara për njohjen e gjendjes së zhvillimit fizik, në mënyrë që të orientohen drejt në marrjen e masave të përshtatëshme për mbrojtjen dhe forcimin e shëndetit të gjeneratës në rritje.

Duke u nisur nga këto konsiderata, ne i shtruam si qëllim veftës qytetit Tiranës, të cilat mund të vlefjë edhe për qytetet e Durrësit, Vlorës dhe Elbasanit, për deni sa aty nuk do të ketë standarte lokale. Për këtë qëllim, ne kryem ekzaminimet antropometrike të 5527 nxënësve të moshës 7-15 vjeç të 11 shkollave të qytetit Tiranës nga shuma e përgjithëshme e nxënësve të shkollave 7 vjeçare e fillore të kryeqytetit — 14.800, në vjetin shkollor 1957-58.

Rezultatet e ekzaminimeve regjistroheshin në një formular të posaçëm që përbante emrin, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, sekundjen, datën e ekzaminimit, gjatësinë e trupit ngritur (në cm), gjatës raksit në pauzë (në cm), peshën (në kg), cirkonferencën e thorës së djathë (në kg), forcën muskulare të shpinës (në kg), deformimet e kolonës vertebrale në bazë të inspeksionit të jashtëm (kifoze, skolioze lordonze dhe kombinime), disa shenja somatoskopike dhe fëmijët, që ndodhen në evidentë të dispensorisë antituberkulare. Si objekt u zgjodhën 10 shkolla shtatëvejçare dhe një shkollë fillore nga lagjë të ndryshme të qytetit, ku u ekzaminuan të gjithë fëmijët. Matjet dhe ekzaminimet janë kryer gjithëmonë në itë mjetë orë (prej orës 8 deri në orën 12 të gđo dite). Rreth 150 ekzaminime ose 27% të numrit total të matjeve u kryen në janar, shkurt, mars, prill 1957, 1100 ekzaminime ose 20% të tërë matjeve u kryen në muajin nëndor dhe dhjetor 1957, ndërsa 2990 të tjerat, ose rreth

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E NXËNËSVE T'EKZAMINUAR NË VITET 1957 - 58

Simbas moshës, seksit, turnit të mësimeve dhe profesionit të prindërve

Pasqyra Nr. 1.

Profesioni prindit															Gjithsel	% 100%	
	7 vjeç		8 vjeç		9 vjeç		10 vjeç		11 vjeç		12 vjeç		13 vjeç				
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
Turni para ditës	143	149	178	156	138	158	73	89	232	188	243	300	275	270	235	237	154 155 37 32 3 3 3448 62.3%
Turni mbas ditës	52	42	263	304	271	288	273	227	113	119	34	36	22	13	6	3	2 — 1 — — — 2079 37. 7%
Puntore	118	103	321	286	233	395	212	169	214	187	185	239	189	200	152	150	103 98 29 23 3 — 3609 65.29%
Nëpunës	77	87	63	168	162	143	125	135	130	110	79	81	90	67	73	82	48 51 9 7 3 3 — 1689 30.5%
Private	—	—	11	5	3	2	7	6	8	6	6	11	10	9	3	7	3 — — — 100 1.8%
Të fjerë	—	1	46	1	11	6	2	6	3	4	7	5	8	7	13	1	2 3 — 2 — — 129 23%

53% të numrit total të ekzaminimeve, u kryen në janar-shkurt, mars 1958. Dhomat ku kryhesin ekzaminimet ishin të gjëra, të ndriçishme, me temperaturë normale (180-220C). Subjekti gjatë ekzaminimit qëndronin në këmbë më shumë se 15 minuta. Fëmijtë me deformacione të theksuara të trupit u përijashtuan nga matjet antropometrike. Për instrumenta u përdorën antropometri, peshorja, metri, spirometri, dinamometri i dorej dhe dinamometri i shpinës.

Numri i vrejtjeve për çdo grup të moshës dhe të seksit lëkundet, mesatarisht prej 155 (minimum) deri në 450 (maksimum), çka përputhet me ato që tregojnë të gjithë autorët.

Vëllimi i vrejtjeve tonë simbas moshës dhe seksit, turnit dhe profisionit të prindërvet paraqitet në pasqyrën Nr. 1. Në bazë të saj, shihet se më tepër të ngjime me vrejtje janë moshat 8, 9, 10, 11 dhe 12 vjeç (me mbi 600 vrejtje), pastaj vijnë moshat 13, 14 vjeç (me jo më shumë se 580 raste) dhe në fund moshat, 7, 15 vjeç (me jo më shumë se 390 raste). Nga pasqyra Nr. 2 rezulton, se me raste më të shumta dëme me përqindje më të lartë paraqitet mosha 8 vjeç (16,3%). Përmes grupimin e moshave u-muarr për bazë vjeti me numrin e muajve. Në se nxënësi ishte i një vjeti X dhe nën gjashtë muaj, numri i muajve nuk merrej parasysh dhe mibetej vetëm viti, ndërsa mbi gjashë më muaj shtohej një vit (5).

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E SHKOLLARËVE TË EKZAMINUAR 1957-58 SIMBAS MOSHES NË %

Pasqyra Nr. 2

M o s h a	Numri i vë- rejtjeve	% mbi numrin e përgjithë- shëm të vrejtjeve
7 vjeç	386	6.98%
8	901	16.30%
9	855	15.40%
10	762	13.78%
11	662	11.97%
12	613	11.09%
13	580	10.40%
14	481	8.70%
15	311	5.70%
16	70	1.20%
17	6	0.1%

Nga pasqyra Nr. 1, shihet njëkohësisht se shumica e shkollarëve të ekzaminuar ose 3,448 (62,30%) mësojnë në turnin e paradrekës dhe vëtëm rrëth 1/3, apo 2097 (37,70%) nxënës mësojnë në turnin e pasdrekkës.

Po nga kjo pasqyrë mund të vihet re, se nxënesit e moshave 8,9 dhe 10 vjeç, që kemi ekzaminuar n'e, mësojnë në shumicën e tyre n'e turmin e pas-drekës, ndërsa nxënësit e moshave 7, 11 vjeç e lart mësojnë në shumicën e tyre n'e turmin e paradrekës. Duhet theksuar, se moshat 14, 15, 16 vjeç e kanë të parëndësishëm numrin e nxënësve, që mësojnë në turnin e pasdrekkës.

Në bazë të profesionit të prindërve, nga gjithë të ekzaminuarit, 3,609 ose 65,29%, ishin fëmijë të prindërve me profesion punëtor, 1,689 ose 30,5% nëpunësa, 100 ose 1,5% privatë dhe 129 ose 2,3% të tjera.

Nga shikimi i të dhënavave mbi profesionin e prindërve të fëmijeve të ekzaminuar në pasqyrë rezulton, se kontigjenti i nxënësve me profesiion të prindërve nëpunës, është më i vogël se ai i nxënësve me profesion të prindërve punëtore për të gjitha moshat pa përfashim. Gjithashtu shihet, se ka një pakicë krejt të parëndësishme të nxënësve me profesione të tjera të prindërve në total dhe në qdo moshë veganërisht. (3, 5, 7).

Përpunimi i materialit u-bë me anën e statistikës së variacionit. Siç dihet, për vlerësimin e zhvillimit fizik ekziston metoda mëkanike e gabuar, që edhe sot akoma përdoret në klinikë — metoda e indekseve (1, 5).

E meta kryesore e indekseve qëndron në faktin, se këta përfaqësojnë vetëm lidhje të shenjave të vëgantë të zhvillimit fizik midis tyre, çkëputur nga vëgoritë e moshës dhe të seksit. Për këtë arësy, ne përdorëm metodën e përpunimit të standardeve. Pas mbledhjes së materialit dhe përpunimit të tij, e kalkulua mesatarja arithmetike e ponderuar për çdo grüp moshe e sekzi veganërisht. Më qëllim që të gjëndet shkalla e saktesisë së mesatares, e cila varet nga numri i vërejtjeve dhe nga ndryshueshmëria e radhës, ne kalkulam gabimin mesatar kuadratik (deviacioni sigmal). Dihet, se sa më e ndryshueshme të jetë radha e variacionit nga mesatarja, aq më pak përfaqësonjëse është mesatarja arithmetike dhe anasjelltas; deviacioni sigmal (σ) shpesht në shifra absolute madhësinë e ndryshueshme të radhës.

Në se lëkundjet do të jenë prej -1 sigma deri në -2 sigma, atëherë këto janë madhësi nën mesataren dhe nën -2 sigma janë madhësi të ulëta. Madhësitë që lëkunden brënda amplitudës -1 sigma deri $+1$ sigma janë madhësi mesatare. Kur lëkundjet shtrihen prej $+1$ sigma deri në $+2$ sigma, janë madhësi mbi mesataren; mbi $+2$ sigma konsiderohen madhësi të larta. Sikurse trezon V.V. Bunak, duhet rënvizuar se deviacioni sigmal varet nga madhësia absolute e shenjës në përgjithësi; me fjalë të tjera, në radhët e gjatësë së trupit, sigma zakonisht është më e madhe, se sa në radhët e peshës apo të cirkonfencës toracike. Në fëmijët, ku gjatësia e trupit është më e vogël, se sa tek të riturit, sigma, rregullist, është më e vogël (5).

Për të përjashtuar influencën e madhësise absolute të shenjës, sigmën ne e shprehim në përgjindje ndaj mesatares arithmetike dhe nxjerrim kështu koeficientin e variacionit (v), që përtregon një numër, i cili na jep mundësinë të krahasojmë përhapjen e radhëve që dallohen nga madhësia e tyre aësolute.

Përvog koeficientit të variacionit, ne kemi kalkuluar edhe gabimin mesatar të mesatares arithmetike $m(M)$; ky nuk është gabimi i vrojtimit, por një masë me sinqjifikacion përfaqësonjës ose një masë e saktësisë së një parametri të dhënë (5).

Ne kalkuluar mesataren arithmetike të grupeve të moshave dhe selseve të shkollarëve të qytetit Tiranës prej 7 — 15 vjeç për gjatësinë e trupit, peshën, cirkonferencën thoracike, kapacitetin vital të muskulare shkërive, forcën muskulare të dorës së gjathtë dhe forcën muskulare të shpinës. Të dhënat mbi kapacitetin vital të mushkërive, dinamometrinë e muskulaturës së shpinës metrinë e dorës së gjathtë, dinamometrinë e muskulaturës së shpinës dhe ekstremiteteve inferiore janë botuar në revistën Shëndetësia Popullore Nr. 1 — 1959.

Në pasqyrën Nr. 3 dhe 4 pasi janë respektuar kërkesat për të cilat flasin V.V. Bunauk (5), L.A. Sirkin (6), D.I. Aron dhe të tjere (3, 5, 6, 9) jepen standartet e mesatareve arithmetike të grupeve të moshave dhe të sekshit të shkollarëve të Tiranës për gjatësinë, peshën dhe cirkonferencën e toraksit, së bashku me deviacionin sigmal, gabimin mesatar të mesatares arithmetike dhe koeficientin e variacionit. Veç këtyre, për peshën dhe cirkonferencën thoracike, paragjeten koeficienti i koreacionit me gabimin probabël të tij si dhe koeficienti i regresionit së bashkun me sigmën e vegantë të radhës regressive.

Metoda e vlerësimit të zhvillimit fizik me anën e deviacioneve sigmale të shenjave të ndryshme, me gjithë anët pozitive, ka edhe dezavantazhet e saj, që kanë të bëjnë, kryesisht, me faktin, se në këtë rast mesatarja apo karakteristika e zhvillimit fizik të individëve të vegantë jepet duke nxjerë në mënyrë të shkëputur shenjat e veganta të zhvillimit fizik të shumë individëve, pa marrë parasysh specifikkimin e lidhjeve dhe proporcioneve, lëkundjeve të shenjave të veganta midis tyre në kompleks për çdo individ të vegantë me përgjithësinim e tyre të mënyrës së tij.

Vlerësimi i zhvillimit fizik, pasi të përpunojen standartet dhe të eshtë e saktë, vetëm atëhere kur lëkundja e gjatësisë së trupit shtrihet brënda ± 1 sigma; në madhësi ± 1 sigma dhe nën -1 sigma, kjo metodë nuk jep saktësi të vlerësimit (1, 3, 4).

Eshtë për këtë qëllim, që ne kalkuluan koeficientin e koreacionit dhe të regresionit të peshës dhe të cirkonferencës thoracike ndaj gjatësë së trupit.

Gjatësia e trupit konsiderohet si shenjë kryesore e zhvillimit fizik, e cilë eshtë vendimtare në konstrukcionin fizik të organizmit të individualëve të vegantë, ajo karakterizohet me një stabilitet relativist me pakë se shenjat e tjera. Prandaj, gjatë nxjerries së lidhjeve korelativë ajo konsiderohet si themelore (1, 4).

Koeficienti i koreacionit jep vetëm një ide të madhësisë së raporteve midis lëkundjeve të dy shenjave (p.sh. peshen me gjatësinë), ndërsa koeficienti i regresionit tregon ekzakt, se sa lëkundet pesha dhe cirkonferanca toracike, kur gjatësia e trupit lëkundet në 1 cm. (1, 4, 5). Në bazë të pasqyrës Nr. 3 koeficienti i koreacionit të peshës me gjatësinë në një gjemtë eshtë i harrë për moshat 7, 8, 9, 10, 13, 15 vjeç dhe i ndjishëm për moshat 11, 12 dhe 14 vjeç. Përsë i përket cirkonferencës

STANDARTET E ZHVILLIMIT FIZIK TË SHKOLLARËVE TË Q. TIRANËS

(Simbas materialeve të eksaminitive të vjetëve 1957-1958)

Pasqyra Nr. 3

D J E M T È

Shenja	Mosha	N	M \pm m	$\pm \sigma$	V	r $\pm \sigma_r$	R $\pm \sigma_R$
Gjatësia e trupit							
7	195	116,96	\pm 0,35	\pm 5,01	4,2		
8	441	119,38	\pm 0,24	\pm 5,06	4,2		
9	409	123,66	\pm 0,28	\pm 5,75	4,6		
10	345	127,45	\pm 0,31	\pm 5,91	4,7		
11	355	133,11	\pm 0,33	\pm 6,05	4,5		
12	277	137,16	\pm 0,41	\pm 6,09	5		
13	297	141,36	\pm 0,37	\pm 6,41	4,5		
14	241	147,49	\pm 0,59	\pm 8,77	5,8		
15	156	150,4	\pm 0,60	\pm 7,60	5		
Pesha e trupit							
7	195	20,85	\pm 0,15	\pm 2,24	10,6	0,794	\pm 0,01
8	441	21,82	\pm 0,12	\pm 2,52	11,4	0,695	\pm 0,01
9	409	23,9	\pm 0,15	\pm 3,1	12,9	0,77	\pm 0,01
10	345	25,42	\pm 0,15	\pm 2,9	11,3	0,81	\pm 0,02
11	355	28,6	\pm 0,23	\pm 4,3	15	0,57	\pm 0,02
12	277	30,52	\pm 0,27	\pm 4,6	15	0,68	\pm 0,02
13	33,07	\pm 0,27	\pm 3,75	\pm 4,5	0,78	\pm 0,01	\pm 1,984

Shenja	Mosha	N.	M ± n	± σ	V	r ± σr	R ± σR
Cirkonferenca e Toraksit							
	14	241	37,49	± 0,44	18,2	0,6664	0,556 ± 5,93
	15	156	40,52	± 0,48	14,8	0,778	0,624 ± 3,78
	7	195	56,0	± 0,20	2,90	0,106	0,288 ± 2,64
	8	441	57,0	± 0,11	2,41	0,489	0,002 ± 2,1
	9	409	38,0	± 0,33	3,78	0,51	0,002 ± 3,27
	10	345	60,0	± 0,17	2,65	0,5	0,004 ± 2,3
	11	386	61,1	± 0,2	3,7	0,46	0,002 ± 3,29
	12	277	63,36	± 0,19	5,9	0,53	0,002 ± 2,67
	13	297	65,64	± 0,20	3,35	0,739	0,01 ± 2,24
	14	241	67,77	± 0,26	4,15	0,603	0,473 ± 3,32
	15	156	69,4	± 0,22	3,92	5,6	0,621 ± 0,03
						0,316	± 3,1

Shenja	Mosha	N	$M \pm m$	$\pm \sigma$	V	$r \pm \sigma_r$	$R \pm \sigma_R$
Cirkonferencia e							
Toraksit							
	7	191	54,96	$\pm 0,18$	2,5	0,408	$\pm 0,04$
	8	460	55,62	$\pm 0,12$	2,16	0,442	$\pm 0,02$
	9	446	57,2	$\pm 0,15$	3,20	0,479	$\pm 0,02$
	10	316	59,02	$\pm 0,18$	3,1	0,52	$\pm 0,02$
	11	307	59,89	$\pm 0,22$	3,98	0,523	$\pm 0,02$
	12	336	62,24	$\pm 0,24$	4,4	0,51	$\pm 0,02$
	13	283	65,46	$\pm 0,26$	4,49	0,564	$\pm 0,02$
	14	240	68,47	$\pm 0,27$	4,87	0,259	$\pm 0,04$
	15	155	69,32	$\pm 0,34$	4,2	0,447	$\pm 0,04$

toracike tek djemtë koeficienti i koreacionit i lartë vijet re vetëm në 13 vjeç, i ndjishëm për moshat 9, 10, 12, 14 dhe 15 vjeç dhe i mjaftueshëm për moshat 7 dhe 8 vjeç. Nga sa duket, tek djemtë shkalla e proporcionalitetit të lartë, paracitet me një stabilitet relativist të mirë në koreacionin midis peshës dhe gjatësisë, ndërsa në cirkonferencën toracike ky stabilitet proporcionalisht është më i ulët.

Në bazë të pasqyrës Nr. 4 koeficienti i koreacionit të peshës me gjatësinë është i lartë vetëm në moshën 10, 11, 13 vjeç, i ndjeshëm në moshat 9 dhe 15 vjeç, i mjaftueshëm në moshat 7, 8, 12, 14 vjeç.

Përsa i përket koeficientit të koreacionit të cirkonferencës toracike me gjatësinë e trupit, tek vajzat ky është i ndjishëm në 10, 11, 12, 13 vjeç, i mjaftueshëm në 7, 8, 9, 15 vjeç, i ulët në 14 vjeç dhe në asnjë moshë nuk ka koreacion të lartë. Këto të dhëna flasin në përgjithësi për një proporcionalitet të ulët të cirkonferencës toracike në gjatësinë tek vajzat, se sa për peshën me gjatësinë; proporcionaliteti i cirkonferencës toracike me gjatësinë është më i ulët në moshten 14 vjeç. Përveg këtyre, relativisht me koeficientin e koreacionit tek rëvë të moshës e cirk. toracike tek djemtë, koeficienti i koreacionit tek vajzat flet për një proporcionalitet më të vogël të këtyre dy shenave në krahasim me gjatësinë.

Koeficienti i regresionit vlen për të ndërtuar pasqyrat e vlerësimit individual të zhvillimit fizik në kompleksin dhe koreacionin reciprok të shenjave kryesore. Plikërisht përkëtë, ne e përdorëm atë për të ndërtuar pasqyrat e vlerësimit individual të zhvillimit fizik të shkollës së moshës 7-15 vjeç të qytetit Tiranës.

Nga të gjitha këto, është evident avantazhi i vlerësimit të zhvillimit fizik simbas pasqyrave të vlerësimit individual me anën e shkallëve të regresionit, në krahasim me pasqyrat (standartet) e ndërtuara në bazë të deviacioneve sigmale (2, 5).

Pasqyrat për vlerësimin individual të zhvillimit fizik kanë një rëndësi të veçantë praktike për pediatritë dhe mjekët shkollorë.

Vlerësimi i zhvillimit fizik të nxënësve, simbas shkallës së regresionit kryhet me anën e sigmës së veçantë (σ_R) — deviacioni mesatar kuadratik të regresionit. Sigma e vegantë tregon shkallën e ndryshme shumërisë së madhësisë së radhës së regresioneve nga mesatarja arithmetike dhe është kriteri i vlerësimit të ndryshimit të treguesave të peshës së madhësisë së të njëjtit individ.

Vlerësimi i zhvillimit fizik të çdo nxënësi veganësht kryhet me anën e krahasimit të madhësive të gjatësisë, peshës, cirkonferencës toracike, të fituara nga matjet antropometrike me madhësitë e paratitura në pasqyrat (2, 4, 5).

Në pasqyrën, që i përgjigjet sekshit dhe moshës me nxënësit që e kërkohet madhësia e gjatësisë e afërmë me gjatësinë e nxënësit që e kërkohet madhësia e gjatësisë e afërmë me gjatësinë e peshës dhe të cirkonferencës së toracike, që duhet ti korespondojnë mesatarisht gjatësisë konferencës toracike, që dhënat t'i korespondojnë mesatarisht gjatësisë së dhëne. Pastaj gjendet diferenca midis të dhënavë të pasqyrës dhe atyre të fituara nga matja. Në këtë rast, mund të ketë përpunje të plotë të të dhënavë ose lëkundje të ndryshme nga të dhënat e pasqyrës. Nëse ka përpunje, atëherë përcaktohet me një herë grupi i zhvillimit fizik (i ulët, nën mesatoren, mesatar, mbi mesatoren, i lartë), pa

bëre diferencën. Por në qoftë se nuk ka koincidim, atëherë veprohet sipas shembullimit që vijon: nxënësi 10 vjeç (djalë) me gjatësi 131,5 cm, peshë 31 kg, cirkonferencia toracike 63 cm. Në pasqyrën vlerësonjëse (22) përcaktojne se nxënësi 10 vjeç (djalë) me gjatësi 131,5 em. duhet të ketë peshë 27 kg, dhe cirkonferencë toracike 60,8 cm. Nga gjatësia nxënësi në fjalë parashitet me madhësi mesatare. Për treguesit e tjerë (peshën dhe cirkonferencën toracike), duhet bëre diferenca e pasqyrës (27 kg, peshë 27 kg, dhe cirkonferencë toracike). Në këtë mënyrë, diferenca do të jetë 31 kg — 27 kgr. = +4 pér peshën dhe 63 cm. — 6,80 = +2,2 cm. (cirkonferencia toracike). Deviacioni mesatar kundrastik i radhës së regresionit pér këtë seks e moshë është $\pm 1,7$ pér peshën dhe $\pm 2,3$ pér cirkonferencën toracike. Si pasojë, diferenca e peshës faktike (+ 4 kg) është e përfshirë në mbi $+ 2\sigma$ (R) dim.th. në madhësinë «e lartë» ndërsa diferenca e cirkonferencës toracike (+ 2,2) përfshihet në madhësi prej $+ 1\sigma$ (R) deri në $- 1\sigma$ (R) dim.th. në madhësinë mesatare. Në përfundim, nxënësi në fjalë ka gjatësinë dbe cirkonferencën toracike brenda madhësive mesatare, ndërsa peshën të lartë.

Dihet, se në jetë mund të ndeshen variantet apo kombinimet më të ndryshme të treguesave themelorë të zhvillimit fizik, dim.th. të gjatësisë, peshës dhe cirkonferencës së toraksit (3, 5). Mund të ketë, p.sh. njerez me shtat shumë të gjatë, me peshë shumë të madhe dhe me toraks shumë të gjërë (proporcionalist, të zhvilluar) ose njërsë shtat lartë me nutricion normal dhe gjoks të gjerë etj, etj. Sejila prej këtyre vëgorive karakteristike të zhvillimit fizik duhet të gjejë vëndin e saj në vlerësimin e tërësisë së zhvillimit fizik dhe, prandaj, duhet të jepet një vlerësim i tillë, që të reflektojë vëgoritë e 3 treguesave themelorë dhe ndryshimet në marrëdhëni e tyre reciproke dhe vëgas. Për këtë, nëpërmjet të pasqyrës së vlerësimit individual ne kryejmë vlerësimin e gjatësisë së trupit (p.sh. i lartë, mbi mesataren, mesatar, nën mesaten ose i ulët) (5) dbe pastaj vlerësojmë peshën dhe cirkonferencën toracike, me qëllim që të përcaktohet konstruktioni fizik i individit. Kjo illoj karakteristike e konstruktionsit të trupit (dim.th. karakteristika vlerësonjëse komplekse e peshës dhe cirkonferencës toracike) nuk ka të bëjë aspak me kuptimin mbi tipat e konstitucionit morfolgjik, që siç dihet, është piknija e konceptioneve pseudosohençore, metafizike rnantropologji. Duke u ristur nga pikëpamjet e sotme mbi tërësinë e organizmit dhe mbi rendësinë e treguesave të vëçantë të zhvillimit fizik, pér të gjykuar mbi dinamikën e zhvillimit fizik dhe posaçërisht mbi proporcionalitetin e këtij zhvillimi, duhet të përdoret një grupim, klasifikim racional (2, 5). Në këtë drejtim është pér tu shënuar punimi i G.M. Naïmark (10) mbi «spektrin e rrjetes», një illoj pasqyre, në të cilën koreacionet e peshës, gjatësisë në çdo moshë dhe seks, shënonhen me zona të ngjyrosura me ngjyra të ndryshme (variantet e rrjetes) dbe punimi i VI. Kapalini et al. (8) mbi metodikën e vlerësimit krahasonjës të zhvillimit fizik në kolektivat e vëçantë, që merr pér bazë gjatësinë pér çdo moshë dhe rruajtjen e proportioneve, të ndara në 5 grupe të mëdha.

A. I. Pahomicev (25), në bazë të kriterit të kombinacioneve të gjatësisë dhe konstrukcionit të trupit, jep skemën e tij të vlerësimit të zhvillimit fizik, që është e ndarë në 6 grupe. Simbas A.I. Pahomicev

vit, në skemën e tij mund të përfshilen 99% të të gjithë të ekzaminuarve; mirëpo, në bazë të të dhënave tona rezultoton, se nga kjo skemë mund të përfshihen vjetëm 94,6% të të gjithë të ekzaminuarve prej nesh (bile në raste të pjesëshme edhe më pak), duke mbetur jashtë saj 5,4% të tyre.

Me qëllim që të ndërtojmë një skemë racionale të vlerësimit krahonjës të zhvillimit fizik individual në kolektiva të ndryshme, ne i ndamë të gjitha vërejtjet tona në pasqyrë, që përfshin 125 profile, teorikisht të mundëshme (me anën e pasqyrave të vlerësimit në bazë të sigmës së vegantë të koeficientit të regresionit). Si rezultat, u vu re se në 24 prej varianteve të këtyre profileve të zhvillimit fizik të nxënesve nuk u vërtetua asnjë rast. Në këtë mënyrë materjalit i yne, në fakt, përfshin vlerësimt 101 nga të 125 variantet e mundëshme. Mirëpo, nga një analizë më e hollë e shpërndarjes së këtyre varianteve të profileve, rrjedh, se ndër të 101 variantet e porsapërmëndura, 14 prej tyre kanë sejcilë 1–5 raste, duke përfshire gjithësej vlerësimt 39 raste, ose më ekzakt, jo më shumë se sa (0,72%) të gjitha vrojtimeve tona. Me fjalë të tjera, praktikisht çështja qëndron në nevojën e klasifikimit (grupimit) të 87 varianteve, që mbeten, të cilat përbajnë në materialin tonë shumicën dërmorjëse të rasteve (99,28%).

Në përfundim mund të thuhet, se nga të gjitha skemat dhe metodat që ekzistojnë për vlerësimin e zhvillimit fizik të individuve në kolektiva të vegaanta, më i drejti është kriteri i ndekur nga A.I. Pahomiqev (5). Por, me gjithë këtë skema e tij nuk është privuar nga të metat. Së pari, aty nuk janë përfshirë të gjitha variantet praktikisht të mundëshme, në kohë që kryetit Tiranës (sikurse fregojnë materialet tona); së dyti, (ajo që është më e rëndësishme) profilet e zhvillimit fizik, me grupimin e të cilave ndërtuan skemën e tij vlerësonjëse, A.I. Pahomiqev, i nxjerrë në bazë të deviacioneve sigmale të gjatësisë, pështës dhe cirkonferencës toracike, dhe jo në bazë të shkallëve të regresionit, që, pa dyshim, prish unitetin që marrëdhëniet reciproke midis shenjave kryesore të zhvillimit fizik të individit dhe i ul, kështu, skemës, vlerë e saktaqësë së mundëshme të saj.

Në këtë mënyrë, dulek u bazuar kryesishët në kriterin e kombinimit të konstruktionsit të trupit (nutricionit dhe zhvillimit të krahorit), me gjatësinë ne raporte të caktuara dhe në rezultatet e analizës së materialev tona, me qëllim që të evitojen të metat metodike të mësiperme, dulek modifikuar skemën e Pahomiqevit (5), propozojmë skemën tonë të vlerësimit të zhvillimit fizik, e cila, së pari, ndërtohet në bazë të shkallëve të regresionit të shenjave të vegaanta kryesore dhe jo në bazë të deviacioneve sigmale të tyre, së dyti, përfshin 99% të varianteve të profileve të zhvillimit fizik, që praktikisht vihen në në nxënësit e moshës 7–15 vjeç të qytetit Tiranës dhe, së treti, eviton grupimin e përshtatshëm të varianteve të veganta të profileve të ndryshëm. Skema e Pahomiqevit e modifikuar prej nesh përfshin jo 6 (sikurse Pahomiqevi), por 7 grupe të ndarë në nëngrupe dhe variante në mënyrën që vijnë:

Skema e karakteristikës së zhvillimit fizik

I. Grupi i I-vë. Gjatësi e trupit mbi mesaten dhe e lartë me konstruktioni normal dhe të mirë.

1. Nëngrupi i parë. Konstruksion i mirë me gjatësi të lartë dhe mbi mesataren.

a) Varianti i parë: Profillet me gjatësi të lartë (mbi 2 sigma) dhe me peshë dhe cirkonferencë toracike të lartë dhe mbi mesataren.

b) Varianti i dytë: Profillet me gjatësi mbi mesataren (prej 1 deri 2 sigma mbi mesataren) dhe me peshë ose cirkonferencë mesatare, mbi mesataren dhe të lartë.

2. Nëngrupi i dytë. Konstruksion normal (me peshë dhe cirkonferencë toracike brenda madhësive mesatare).

a) Varianti i parë: Me gjatësi të lartë në prani të konstruksionit normal.

b) Varianti i dytë: Me gjatësi mbi mesataren në prani të konstruksionit normal.

II. Grupi i II-të. Profillet me gjatësi trupi mesatare dhe nën mesatare dhe konstruksion të mirë dhe normal.

1. Nëngrupi i parë. Konstruksioni i trupit i mirë (profile me peshë dhe cirkonferencë toracike mbi mesataren dhe të lartë) gjatësi të trupit mesatare.

2. Nëngrupi i dytë. Konstruksion normal (profile me peshë dhe cirkonferencë në madhësitë mesatare). me gjatësi në madhësi mesatare.

3. Nëngrupi i tretë. Gjatësi nën mesatare në prani të dy variantave të konstruksionit të trupit.

a. Varianti i parë: me konstruksion të mirë (peshë dhe cirkonferencë toracike mbi mesataren dhe të larta).

b) Varianti i dytë: me konstruksion normal (peshë dhe cirkonferencë toracike mesatare).

III. Grupi i III-të. Profillet me gjatësi të trupit të lartë, mbi me-sataren dhe mesatare në prani të konstruksionit nën mesataren.

1. Nëngrupi i parë. Profillet me konstruksion nën mesataren dhe shtat të lartë (2 variante).

a) Varianti i parë: me kryesishë gjoks të ngushtë (profiller me cirkonferencen toracike nën mesataren, me gjatësi të lartë dhe me peshë mesatare, mbi mesataren ose të lartë).

b) Varianti i dytë: me kryesishë rënje të nutricionit (profiller me peshë nën mesataren me gjatësi të lartë dhe cirkonferencë toracike mesatare, mbi mesataren ose të lartë).

2. Nëngrupi i dytë. Profillet me konstruksion nën mesataren dhe shtat mbi mesataren (2 variante).

a) Varianti i parë: me kryesishë gjoks të ngushtë (gjatësi mbi mesataren dhe peshë mesatare, mbi mesataren dhe të lartë në prani të cirkonferencës toracike nën mesataren).

b) Varianti i dytë: profillet me kryesishë rënje të nutricionit (gjatësi mbi mesataren dhe cirkonferencë toracike mesatare, mbi mesataren dhe të lartë me peshë nën mesataren).

3. Nëngrupi i III-të. Profillet me konstruksion nën mesataren dhe me shtat mesatar (2 variante).

